



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 984 / Prot.
3

Tiranë, më 4 11 2016

REKOMANDIM

Nr. 26 datë 4 11 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Diplomat" – Diplomat HY sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.200, datë 20.09.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "Diplomat", konform procedurave administrative, me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Hotel "Diplomat" – Diplomat HY sh.p.k. Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.200, datë 20.09.2016 të Komisionerit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
2. Kontrolluesi mban/ruan një kopje të pasaportës së klientëve në format elektronik.
3. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin zyrtar <http://www.diplomathotels.al>.

Konstatimet e mësipërme përbëjnë shkelje të neneve 5 dhe 18 të Ligjit nr. 9887 për "Mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, procesverbalit të inspektimit ju bashkëngjitën dokumentet:

- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i Q.K.R. së.
- Printim nga portali <http://www.diplomathotels.al>.
- Manual i rregullave, politikave dhe procedurave të përgjithshme të punonjësve.
- Kontratë individuale pune.
- Printim nga ndërfaqja e sistemit elektronik të menaxhimit të të dhënave.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet: *“Konform ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale, do të pajisemi menjëherë me tabelat sinjalizuese mbi prezencën e sistemit të vëzhgimit me kamera, në ambientet tona”*.

Kontrolluesi, Hotel *“Diplomat”* – Diplomat HY sh.p.k. Tiranë, ka dokumentuar para zhvillimit të seancës dëgjimore, riparimin e konstatimeve nga grupi i kontrollit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Hotel *“Diplomat”* - Diplomat HY sh.p.k., Tiranë, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi Hotel *“Diplomat”* - Diplomat HY sh.p.k., Tiranë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën *“Politikat e Privatësisë”*.
3. Kontrolluesi Hotel *“Diplomat”* - Diplomat HY sh.p.k., Tiranë, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, në vazhdimësi për pikën e parë dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për pikën e dytë, nga dalja e këtij rekomandimi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një

kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 4 . 11 .2016

